

## **KËRKESË**

**Drejtuar:** Bordit të Administrimit, Universiteti i Tiranës,  
Z. Skerdi Dafa, Administrator i Universitetit të Tiranës

**Lënda:** Mbi disbursimin e fondeve të bursave të studentëve

Bordi Kombëtar Studentor përbëhet nga studentë të të gjithë universiteteve të Shqipërisë, por është i pavarur nga strukturat e tyre të brendshme.

U bënë tashmë më shumë se katër muaj që mbi 85% e studentëve (sipas sondazheve të realizuara nga ana jonë) përfitues të bursave nuk kanë marrë ende asnjë qindarkë nga fondi që duhet të shpërblejë mundin dhe përkushtimin e tyre për të qënë profesionistët dhe ekspertët e së ardhmes.

Ky fond është një mbështetje financiare modeste në mënyrë që këta studentë të punojnë fortë dhe të vazhdojnë të mbajnë rezultate të shkëlqyera. Këto vonesa janë të papranueshme dhe dëmtojnë ecurinë e tyre.

Ne kërkojmë kalimin e menjëhershëm të të gjitha fondeve të këtyre katër muajve në llogaritë bankare të studentëve, jo më vonë se data 23 shkurt 2022 dhe disbursimin e fondeve brenda afateve të duhura kohore në vazhdim.

*Me respekt,*